

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINË

CN.nr.249/13 & CN.nr.467/2013

19 Gusht 2013

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINË në shkallë të parë përmes Gjyqtares së EULEX ROSITZA BUZOVA në lëndët e bashkuara të propozuesve A. S., H. S., B. S., D. S. dhe N. S., të gjithë nga fshati Mazgit, Komuna e Obiliqit, përfaqësuar nga Avokati A. A. K. nga Prishtina, kundër kundër-propozuesve QRK dhe MMPH–Prishtinë, përfaqësuar nga MD – Prishtinë përmes Zyrtares së Lartë Ligjore N. A. dhe SH. H. nga Divizioni për Përfaqësim Gjyqësor për përcaktim të kompensimit për pronat e paluajtshme të shpronësuara me masë të përkohshme të sigurisë sipas Nenit 306, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-006 mbi Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare Nr. 38/2008), e ndryshuar dhe e plotësuar nga Ligji Nr. 04/L-118 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2012) (“LPK”) në lidhje me Nenin 3 të Ligjit Nr. 03/L-007 Mbi Procedurën Jo Kontestimore (Gazeta Zyrtare Nr. 5/2009) (“LPJ”) dhe Neni 39, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-139 mbi Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme (Gazeta Zyrtare Nr. 52/09), e ndryshuar dhe e plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-205 (“LSHPP”), pas dëgjimit sipas Nenit 306, paragrafi 2 i LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ të marrë më datën 19 Gusht 2013, nxjerr si në vijim

A K T V E N D I M

I. ANULOHET sipas Nenit 306, paragrafi 3 i LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ Aktvendimi CN.nr.249/2013 & CN.nr.467/2013 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, i datës 30 Korrik 2013 në pjesën e pikëve II–III të dispozitivit duke **SHFUQIZUAR** masën e përkohshme të sigurisë duke ndaluar kundër propozuesit – Q.K- MMPH dhe çdo palë të tretë për rrënim të ndërtesës banesore pesë kate në parcelën katastrale nr.152-0, të regjistruar në Certifikatë për të Drejtat Pronësore të Paluajtshme Nr. UL-72614046-00002, Zona Katastrale Mazgit, Komuna e Obiliqit.

II. Ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi në pajtim me Nenin 310, paragrafi 4 i LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ.

III. Një kopje e këtij aktvendimi do t'i dorëzohet Stacionit Policor në Obiliq.

ARSYETIM

1. Në lëndët civile të bashkuara CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, propozuesit A., H., B., D. dhe N. S. të gjithë nga fshati Mazgit, Komuna e Obiliqit kanë parashtruar propozim kundër kundër-propozuesve QRK dhe MMPH për përcaktimin e kompensimit për pronat e paluajtshme, e shpronësuar me Vendim Përfundimtar Nr. 03/100 të datës 12 Nëntor 2012 për ndërtim të autostradës VËRMICË – MERDARE nga pronari i tyre i mëhershëm tani i ndjeri F. (H.) S., duke përfaqësuar palët e parcelave katastrale nr.149-0, nr.150-0, nr.152-0, ZK Mazgit. Kërkesa për gjykatën është për të modifikuar shumën e kompensimit të specifikuar në Vendimin Përfundimtar duke e rritur atë deri në vlerën e tregut të pronave të paluajtshme të shpronësuara.
2. Më datën 11 Korrik 2013, propozuesit kanë parashtruar propozim për masë të sigurisë, miratuar pjesërisht dhe pjesërisht refuzuar me aktvendimin CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 30 Korrik 2013 – sipas Nenit 306, paragrafi 1 dhe Neni 297, paragrafi 1, pikat a) dhe b) të LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ ishte caktuar masa e përkohshme e sigurisë duke ndaluar rrënimin e ndërtesës banesore pesë kate në parcelën katastrale nr.152-0 derisa të përmbushen të gjitha kushtet ligjore për lirim të saj, të paraqitura në pikën III të dispozitivit.
3. Aktvendimi CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë të datës 30 Korrik 2013 iu ishte dorëzuar menjëherë kundër propozuesve në pajtim me Nenin 306, paragrafi 2, fjalia e parë e LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ më datën 30 Korrik 2013. Ishte dorëzuar gjithashtu propozuesve në përputhje me Nenin 110, paragrafi 1, fjalia e parë e LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ më 31 Korrik 2013.
4. Më datën 2 Gusht 2013 brenda afatit 3 ditor sipas Nenit 306, paragrafi 2, fjalia e dytë e LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ, një kërkesë me nr.ref. 1317, të datës 2 Gusht 2013 për heqje të masës së përkohshme të sigurisë ishte parashtruar nga kundër- propozuesi QK – MMPH përmes MD si përfaqësues i tyre ligjor sipas Nenit

**AKTVENDIM CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 IGJYKATËS THEMELORE TË PRISHTINËS,
ME DATË 19.08.2013**

67, paragrafët 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 03/L-221 mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare Nr. 56/2008), e ndryshuar dhe e plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-048 (Gazeta Zyrtare Nr. 76/10) dhe Ligji Nr. 04/L-116 (Gazeta Zyrtare Nr. 46/12) ("LMFPP"). Brenda afatit 3 ditor të paraparë sipas Nenit 102, paragrafi 1 në lidhje me Nenin 99, paragrafi 2, fjalia e parë, Neni 78, paragrafi 2, Neni 93, paragrafët 3 dhe 4 të LPK me aktvendimin CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë të datës 5 Gusht 2013 në lidhje me Nenin 3 të LPJ, MD e ka përfunduar kërkesën e saj fillestare, të datës 2 Gusht 2013 përmes parashtresës me nr.të ref. 1317, të datës 7 Gusht 2013. E përmbledhur, kundër-propozuesit e ankimojnë masën e përkohshme të sigurisë si të pabazuar pasi që të gjitha kushtet për lirim të ndërtesës në parcelën katastrale nr. 152-0, ZK Mazgit janë plotësuar në mënyrë të rregullt në pajtim me ligjin dhe kërkesën për heqje të menjëhershme të saj.

5. Seanca e masës së sigurisë sipas Nenit 306, paragrafi 2, fjalia e dytë e LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ filloi më 13 Gusht 2013. Pas shtyrjes për marrjen e provave të kërkuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) rreth pagesës së kompensimit të shpronësimit sipas Nenit 438, paragrafi 1, pika a) e LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ, dhe për arritje të një marrëveshje jashtë gjyqësore nga palët sipas Nenit 438, paragrafi 1, pika a) e LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ ishte arritur më 19 Gusht 2013.

6. Parashtresa me nr.ref. 1317 e MD e datës 2 Gusht 2013, fillimisht e parashtruar si kërkesë për heqje të masës së përkohshme të sigurisë e caktuar me aktvendimin CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 30 Korrik 2013, ishte precizuar me parashtresën vijuese Nr. 1317 të MD, të datës 7 Gusht 2013 dhe deklarata e përfaqësuesit të saj Zyrtarit të Lartë Ligjor SH. H. në seancë më datën 13 Gusht 2013. Kështu mungesa sipas kualifikimit ligjor të kësaj kërkesë është hequr dhe është bërë e vlefshme në mënyrë retroaktive sipas Nenit 102, paragrafi 2 i LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ të konsiderohet e parashtruar fillimisht si përgjigje e kundër-propozuesve, duke kundërshtuar në pajtim me Nenin 306, paragrafi 2 i LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ masa e përkohshme e sigurisë e caktuar me aktvendimin CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 e Gjykatës Themelore në Prishtinë e datës 30 Korrik 2013 dhe duke kërkuar pas mbajtjes së seancës rreth saj të anulohet me aktvendim të

**AKTVENDIM CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 IGJYKATËS THEMELORE TË PRISHTINËS,
ME DATË 19.08.2013**

gjykatës së shkallës së parë sipas Nenit 306, paragrafi 3 i LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ. Nuk ka baza për hedhje poshtë të saj. Në rradhë të parë, aktvendimi CN.nr.249/2013 & CN.nr.467/2013 i Gjykatës Themelore, i datës 30 Korrik 2013 ishte dorëzuar tek kundër-propozuesit më datë 30 Korrik 2012 – parashtresë me nr.ref. 1317 të MD, e datës 2 Gusht 2013 ishte parashtruar para kalimit të afatit kohor prej 3 ditësh të paraparë me Nenin 306, paragrafi 2, fjalia e dytë e LPK-së në lidhje me Nenin 3 të LPJ. Prandaj nuk është e vonuar. Së dyti, i ka të gjitha parakushtet e kërkuara nga dispozitat e përgjithshme të Nenit 99, paragrafët dhe 3 të LPK-së në lidhje me Nenin 3 të LPJ-së, si dhe deklaratë mbi bazat e kërkuar nga dispozitat speciale të Nenit 306, paragrafi 2, fjalia e tretë e LPK-së në lidhje me Nenin 3 të LPJ-së. Parashtresat me nr.ref.1317 të datës 2 dhe 7 Gusht 2013 përbëhen prej 11 faqeve me vërejtje të detajuara mbi bazat për masë të përkohshme të sigurisë dhe nuk ka mundur të hedhet poshtë për mangësi për shkak të arsytimit që mungon sipas Nenit 306, paragrafi 2, fjalia e tretë e LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ. Së treti, e përjashtuar është gjithashtu hedhja poshtë për palejueshmërinë e ndihmës së kërkuar juridike – në mënyrë të qartë është precizuar nga përfaqësuesi i kundër-propozuesve si përgjigje sipas Nenit 306, paragrafi 2 i LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ, mjeti juridik në veçanti i paraparë për shqyrtim të masës së përkohshme të sigurisë nga gjykata e shkallës së parë që e ka caktuar atë pa njoftim paraprak të palës duke kundërshtuar sigurinë. Për këto arsye, kërkesa për hedhje poshtë e përfaqësuesit të autorizuar të propozuesve të bërë në seancën e datës 13 Gusht 2013 nuk miratohet.

7. Pas shqyrtimit të vetëdijshëm dhe të kujdesshëm të të gjitha provave të administruara dhe argumentet e palëve të paraqitura në seancë sipas Nenit 306, paragrafi 2 i LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ, gjykata konstaton të dëshmuar si e përmbushur në rast se kushtet ligjore për lirim të ndërtesës banesore në parcelën katastrale nr.152-0 ZK Mazgit e caktuar me Aktvendim CN.nr.249/13&CN.nr.467/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, e datës 30 Korrik 2013 si modalitete për kryerje të masës së përkohshme të sigurisë të caktuar duke ndaluar rrënimin e kësaj prone.

Vendimi Preliminar sipas Nenit 10 të LSHPP

8. Ai ishte paraqitur me parashtrësë të nr.ref. 1317 të MD, së datës 7 Gusht 2013, dhe administruar në seancë të mbajtur më datën 19 Gusht 2013, Vendimi Preliminar Nr. 07/87 i Qeverisë, i datës 17 Gusht 2012 bazuar në Nenin 92, paragrafi 4 dhe Neni 93, paragrafi 4 i Kushtetutës, Nenet 10 dhe 45 të LSHPP, Neni 4 i Rregullores Nr. 02/11 për sferat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, të ndryshuar me Rregulloren Nr. 07/11, dhe Neni 19 i Rregullave të Procedurës së Qeverisë, Nr. 09/2011, miratoi në takimin e saj me datë 8 Gusht 2012. Me këtë vendim Preliminar ishte miratuar shpronësimi për interes publik të pronarëve të pronës së paluajtshme dhe zotëruesit e interesit, që gjendej në Sektorin Katastral 9.1 Mazgit dhe Llazarevë, Komuna e Obiliqit, e specifikuar në tabelë të saj – shtojcë, përfshirë pronat në vijim në ZK Mazgit në emër të F. S.: 1) parcela katastrale nr. 149-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej 1 262 m², prej të cilës 775 m² janë paraparë për shpronësim të autostradës si parcelë e re katastrale nr. 149/1, ndërsa e pa shpronësuar ka mbetur me sipërfaqe prej 487 m² si parcelë e re katastrale nr. 149/2; 2) parcela katastrale nr. 150-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej 41 775 m², jashtë së cilës 7 655 m² janë paraparë për shpronësim të autostradës si parcelë e re katastrale nr. 150/3 dhe ato të pa shpronësuar kanë mbetur 22 212 m² si parcelë e re katastrale nr. 150/2; 3) parcela katastrale nr. 152-0, , me sipërfaqe të përgjithshme prej 2 144 m², prej së cilës 1115 m² janë paraparë për shpronësim të parcelës katastrale nr. 152/3 (390 m² për rrugën N2 & 725 m² për autostradën), përderisa të pa shpronësuar kanë mbetur 839 m² për parcelën e re katastrale nr. 152/1 dhe 190 m² për parcelën katastrale nr.152/2.

9. Me miratimin e Vendimit Preliminar Nr. 07/87 të datës 17 Gusht 2012, QRK në cilësimin e saj të Organit Shpronësues sipas Nenit 2, paragrafi 1 dhe Nenit 4, paragrafi 3 i LSHPP-së ka vërtetuar sipas Nenit 10, paragrafi 1, nën paragrafi 1 i LSHPP që shpronësimi i këtyre pronave të paluajtshme private sipas Nenit 3, paragrafi 3 i LSHPP plotëson kushtet e parapara nga Neni 4, paragrafi 1, nën paragrafët 1 – 4 i LSHPP (pika 1 e diapozitivit). I përfshirë në Vendimin Përfundimtar sipas Nenit 10, paragrafi 1, nën paragrafi 2 i LSHPP është njoftim për

Pronarët dhe Zotëruesit e Interesit në lidhje me pronat e prekura të së drejtës së tyre për të parashtruar ankesë kundër saj në gjykatën kompetente në përputhje me Nenin 35 të LSHPP (pika 4 e diapozitivit). I përfshirë në Vendimin Përfundimtar sipas Nenit 10, paragrafi 1, nën paragrafi 3 i LSHPP është njoftim që ajo do të bëhet e plotfuqishme në datën e publikimit në Gazetën Zyrtare dhe gazetën e qarkullimit të përgjithshëm në Kosovë në përputhje me Nenin 10, paragrafët 4 dhe 5 dhe Nenin 43 të LSHPP. Prandaj, Vendimi Përfundimtar Nr. 07/87, i datës 17 Gusht 2012 i ka të gjitha parakushtet sipas Nenit 10, paragrafi 1, nën paragrafët 1 – 3 të LSHPP të kërkuara si elementet e përmbajtjes së saj. Më datë 7 Shtator 2012 ishte publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.24/2012 dhe në gazetë të qarkullimit të përgjithshëm në Kosovë (Koha Ditore), kështu duke u bërë e plotfuqishme në pajtim me Nenin 10, paragrafi 5 i LSHPP-së.

10. Hidhet poshtë pretendimi i përfaqësuesit të autorizuar të propozuesve Avokatit A. K. në pikën 6 të parashtresës së tij, të datës 15 Gusht 2013 që *Vendimi Përfundimtar mungon në këtë shpronësim.* Zyrtarisht e verifikuar me efekt dëshmues detyrues në procedurë sipas Nenit 329, paragrafi 1 i LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ me kopje sipas Nenit 101, paragrafi 1 i LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ të këtij dokumenti publik, Vendimin Përfundimtar Nr. 07/87, i datës 17 Gusht 2012 është lëshuar në mënyrë të duhur me shkrim sipas Nenit 10, paragrafi 1, nën paragrafi 1 i LSHPP nga organi publik kompetent – Q. e K.brenda fushëveprimit të fuqive të saja si Organ Shpronësues sipas Nenit 4, paragrafi 3 i LSHPP, duke respektuar Rregullat e saja të Procedurës Nr. 09/11. Hidhet poshtë gjithashtu pretendimi në parashtresën e Avokatit A. K., të datës 15 Gusht 2013 – pika 6 asnjë njoftim sipas Nenit 10, paragrafi 1, nën paragrafi 2 i LSHPP nuk iu është dhënë pronarëve dhe zotëruesve të interesit të pronave të prekura nga Vendimi Përfundimtar të së drejtës së tyre për t'a ankimuar atë para gjykatës kompetente brenda një afati prej 30 ditëve. Në të kundërtën, një njoftim i tillë sipas Nenit 10, paragrafi 1, nën-paragrafi 2 i LSHPP në mjetin juridik të aplikueshëm kundër Vendimit Përfundimtar Nr. 07/87, të datës 17 Gusht 2012 është përfshirë në pikën 4 të diapozitivit të saj.

11. Mungesa e njoftimeve individuale të dorëzuara për A., H., B., D. dhe N. S. sipas Nenit 10, paragrafi 3 i LSHPP është jo me rëndësi në këtë procedurë. *Së pari*, në pajtim me Nenin 10, paragrafi 3 i LSHPP-së brenda pesë (5) ditëve të punës pas miratimit të Vendimit Përfundimtar Organi Shpronësues ia dërgon atë personave, të identifikuar në kërkesë sipas Nenit 8, paragrafi 1, nën paragrafi 3 i LSHPP-së dhe çdo person tjetër i cili pas datës së saj para miratimit të Vendimit Përfundimtar ishte pranuar për përpunim dhe ka vërtetuar me padi të jetë Pronar apo Zotërues i Interesit në lidhje me pronën përkatëse. Si parcela katastrale nr. 149-0, nr.150-0 dhe nr.152-0, ZK Mazgit në datën e miratimit të Vendimit Përfundimtar Nr. 07/87, të datës 17 Gusht 2012 dhe deri në skadim të afatit 5 ditësh sipas Nenit 10, paragrafi 3 i LSHPP kanë qenë të gjitha të regjistruara në emër të F. S. (Certifikata e të Drejtave Pronësore të Paluajtshme UL-72614046-0002), e të ndjerit prej datës 22 Maj 2005 (Numri rreshtor i certifikatës së vdekjes Nr. 026, nr ref. 178 i Agjencionit të Regjistrimit Civil – Obiliq, i datës 9 Korrik 2008). Duke pasur parasysh vdekjen e F. S. më datë 22 Maj 2005, mungesa e vendimit përfundimtar sipas Nenit 170 LPJ për rregullim të trashëgimisë së tij prej datës së miratimit të Vendimit Preliminar – 17 Gusht 2012 apo deri në skadim të afatit prej 5 ditëve të punës më pas të paraparë me Nenin 10, paragrafi 3 i LSHPP më 24 Gusht 2012, nuk kishte pasur Pronar(ë) bazuar në çdo bazë ligjore për tjetërsim të ngastrave katastrale nr. 149-0, nr. 150-0 dhe nr. 152-0 apo çdo pjese të saj, e as Zotëruesit e të Drejtës së Interesit – titullarët e interesave ligjore, ndryshe nga pronësia, me të drejta apo interesa të dokumentuara me titujt të duhur të fituara me ligj dhe të pranuar në këtë bazë si pjesëmarrës në procedurë të shpronësimit. Pasi deri në miratim të Vendimit Përfundimtar Nr. 07/87 të datës 17 Gusht 2012 pjesët e parcelave katastrale nr. 149-0, nr.150-0 dhe nr.152-0, ZK Mazgit me shpronësim të aprovuar të gjitha janë të regjistruara në katastër në emër të të ndjerit F. S. me ndryshim katastral vijues, *inter alia*, seri reflektuese ligjore në lidhje me këto prona, Vendimin Preliminar Nr. 07/87, të datës 17 Gusht 2012, nuk ka mundur të njoftohet sipas Nenit 10, paragrafi 3 i LSHPP e as ky ish- pronar i vonë, e as ndonjë zyrtar i caktuar si trashëgimtar(ë) i tij. *Së dyti*, Neni 10, paragrafi 5 i LSHPP-së, qartë paraqet që çdo Vendim Preliminar *do të bëhet i formës së prerë në*

datën që ai është publikuar në pajtim me kriteret e Nenit 10, paragrafi 4 dhe Neni 43 i LSHPP. Afati kohor 12 mujor i paraparë me Nenin 11, paragrafi 1, fjalia e parë e LSHPP për lëshim të Vendimit Përfundimtar fillon në datën që ndodh 15 ditë pas datës efektive të Vendimit Preliminar përkatës - bazën e tij, përderisa nuk vazhdohet sipas Nenit 11, paragrafi 2 i LSHPP, më pas ankesa e parashtruar sipas Nenit 35, paragrafi 1 i LSHPP. Afati kohor për paraqitje të tij nga Pronarët e prekur dhe Zotëruesit e Interesit kundër Vendimit Preliminar në gjykatën kompetente, në pajtim me Nenin 35, paragrafi 3, fjalia e parë e LSHPP fillon të rrjedh pas datës së saj efektive siç është specifikuar në Nenin 10, paragrafi 5 i LSHPP, që do të thotë data e publikimit të tij në Gazetën Zyrtare dhe në gazetën e qarkullimit të përgjithshëm në Kosovë. Prandaj, shërbimi individual i Vendimit Preliminar sipas Nenit 10, paragrafi 3 i LSHPP nuk para cakton datën e efektshmërisë, fillimin e afatit kohor për parashtrim të ankesës në gjykatën kompetente kundër tij apo për lëshim të Vendimit Përfundimtar në bazë të saj. Apo, nuk ka baza ligjore të cilat janë të shoqëruara në mënyrë normative me njoftimet individuale për Vendimin Preliminar sipas Nenit 10, paragrafi 3 i LSHPP i dërguar Pronarëve dhe Zotëruesve të Interesit, që janë me rëndësi në procedurën aktuale. Në bazë të këtyre rregullave dhe procedurës, në veçanti të paraqitura për proces të shpronësimit sipas Nenit 3, paragrafi 1 i LSHPP dhe duke mbizotëruar mbi ato të përgjithshme bazuar në epërsinë e garantuar nga Neni 39, paragrafi 1 i LSHPP, pa marrë parasysh për mos dorëzim të Vendimit Preliminar Nr. 07/87, të datës 17 Gusht 2012 propozuesve sipas Nenit 10, paragrafi 3 i LSHPP, është bërë e formës së prerë në pajtim me Nenin 10, paragrafi 5 i LSHPP-së me publikim të saj sipas Nenit 10, paragrafi 4 dhe Neni 43 i LSHPP më datën 7 Shtator 2012. Në datë të njëjtë afati kohor i paraparë nga Neni 11, paragrafi 1, fjalitë e para dhe e dyta e LSHPP-së për lëshim të Vendimit Përfundimtar që ka filluar të rrjedh, si dhe atë të paraparë nga Neni 35, paragrafi 3, fjalia e parë e LSHPP-së për parashtrim të ankesës sipas Nenit 35, paragrafi 3, fjalia e parë e LSHPP-së kundër këtij Vendimi Përfundimtar para gjykatës kompetente nga të gjithë Pronarët dhe Zotëruesit e Interesit në lidhje me të gjitha pronat e paluajtshme – që i nënshtrohen këtij shpronësimi.

12. Ishte pranuar sipas Nenit 321, paragrafi 2 i LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ nga përfaqësuesi i autorizuar i propozuesve në seancë më datën 19 Gusht 2013 se asnjëri nga ata nuk ka iniciuar procedurë gjyqësore sipas Nenit 35 të LSHPP për ankimim të Vendimit Përfundimtar Nr. 07/87, të datës 17 Gusht 2012. Për shkak të mos inicimit, Afati Kohor i Vendimit Përfundimtar i caktuar sipas Nenit 11, paragrafi 1, fjalia e parë dhe e dytë e LSHPP-së nuk është vazhduar sipas Nenit 11, paragrafi 1, fjalia e tretë në lidhje me paragrafin 2 të LSHPP për kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore të shkallës së parë dhe/apo të dytë. Për arsye të njëjtë – mungesa e ankesës së A., H., B., D. dhe N. S. në pritje para çdo gjykate kundër Vendimit Përfundimtar Nr.07/87, të datës 17 Gusht 2012, miratimi i Vendimit Përfundimtar në bazë të saj nuk ka mundur të konsiderohet i bllokuar sipas Nenit 11, paragrafi 3, fjalia e parë e LSHPP përderisa një aktgjykim final i gjykatës apo urdhër të nxirrej sipas Nenit 35 të LSHPP.

13. Ka argumente të shumta të elaboruara nga Avokati A. K. në parashtresën e datës 15 Gusht 2013 – pika 7 dhe në seancë me datë 19 Gusht 2013 për shkeljet e pretenduara të Nenit 4, paragrafi 1, nën paragrafët 1 – 5 të LSHPP-së në këtë shpronësim. Do të thotë, propozuesit akordohen që asnjë qëllim publik legjitim nuk është arritur nga ndërtimi i autostradës VERMICË – MERDARE në kundërshtim me Nenin 4, paragrafi 1, nën paragrafi 1 i LSHPP; shpronësimi nuk ishte ‘i kryer në mënyrë të qartë’ dhe kishte ‘shumë komplikime dhe pasiguri, të pa-eliminuar nga QK – MMPH’ në kundërshtim me Nenin 4, paragrafi 1, nën paragrafi 2 i LSHPP; përfitimet publike që rrjedhin nga ky projekt nuk peshojnë interesat private të ndikuara në mënyrë negative në kundërshtim me Nenin 4, paragrafi 1, nën paragrafi 3 i LSHPP; zgjidhja e pronave për t’u shpronësuar është bërë në mënyrë diskriminuese në kundërshtim me Nenin 4, paragrafi 1, nën paragrafi 4 i LSHPP; Organi Shpronësues nuk i ka plotësuar të gjitha dispozitat e aplikueshme të ligjit në kundërshtim me Nenin 4, paragrafi 1, nën paragrafi 4 i LSHPP. Të gjitha këto argumente është dashur të thirren nga ankesa e parashtruar me kohë kundër Vendimit Preliminar Nr. 07/87 të datës 17 Gusht 2012 sipas Nenit 35, paragrafi 1 i LSHPP-së. Vetëm gjykata e juridiksionit para së cilës është iniciuar kjo procedurë e posaqme

**AKTVENDIM CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 IGJYKATËS THEMELORE TË PRISHTINËS,
ME DATË 19.08.2013**

gjqësore në kohë të duhur do të ishte e autorizuar për të shqyrtuar pajtueshmërinë me kushtet e specifikuar në Nenin 4, paragrafi 1, nën paragrafët 1 – 5 të LSHPP-së apo një aktgjykim duke kërkuar Organin shpronësues që ta modifikojë Vendimin Preliminar dhe fushëveprimi i procedurës së shpronësimit të përjashtojë disa prona të caktuara apo të drejta sipas Nenit 35, paragrafi 7, nën-paragrafi 2 i LSHPP-së. Sidoqoftë, A., H., B., D. dhe N.S. nuk kanë parashtruar ankesë sipas Nenit 35, paragrafi 1 i LSHPP kundër Vendimit Preliminar Nr. 07/87, të datës 17 Gusht 2012 brenda afatit të caktuar nga Neni 35, paragrafi 3 i LSHPP-së. Ashtu që është parandaluar për secilin prej tyre mundësia që më vonë të ankimojnë shpronësimin, që është i miratuar me anë të Vendimit Preliminar Nr. 07/87 të datës 17 Gusht 2012, për mosbindjen me kushtet e specifikuar në Nenin 4, paragrafi 1, nën- paragrafi 1-5 i LSHPP-së. Një shqyrtim i tillë është i palejueshëm në procedurën aktuale nën Nenin 36 të LSHPP-së – paragrafi 1, ku qartë e kufizon pjesën e saj në *ankimimin e Vendimit Final nën Nenin 11 të LSHPP-së*, ashtu që e përjashton mundësinë që të sfidoj në kornizë të saj drejtpërsëdrejti apo tërthorazi *çfarëdo akt tjetër* të organit të shpronësimit, *inter alia* Vendimi Preliminar nën Nenin 10 të LSHPP-së në shpronësimin në fjalë. Neni 36, paragrafi 1 i LSHPP-së më tej e kufizon lëndën në fjalë rreth shumës së kompensimit dhe/ ose dëmtimit që ky Vendim Përfundimtar siguron që t'u paguhet pronareve të prekur dhe Zotëruesve të Interesit të pronës së shpronësuar. Simetrikisht ndaj këtyre kufizimeve, në pajtim me Nenin 36 paragrafi 6 i LSHPP-së gjykata në këtë procedurë të shkallës së parë duhet të këtë vetëm autoritetin e ri kalkulimit të kompensimit apo dëmtimit të specifikuar në Vendimin Përfundimtar, dhe nëse gjen më pak apo më shumë nga ajo që kërkohet me anë të ligjit që të nxjerrin aktgjykimin duke modifikuar shumën përkatëse. Duke pasur parasysh këto kufizime në fushëveprim të procedurës në Nenin 36 paragrafi 1 i LSHPP-së dhe në autorizimet e gjykatës nën Nenin 36 paragrafi 6 i LSHPP-së, legjitimiteti i shpronësimit, i miratuar me anë të Vendimit Përfundimtar Nr. 07/87 të datës 17 Gusht 2012 mund të mos shqyrtohet në vazhdim CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 të Gjykatës Themelore të Prishtinës, as drejtpërsëdrejti e as tërthorazi si një çështje paraprake. Kjo e fundit do të thotë që të korrigojë heqja e A., H., B.,

D. dhe N. S., që të ushtrojnë ankesën kundër Vendimit Preliminar Nr. 07/87 të datës 17 Gusht 2012 në kundërshtim me Nenin 35, paragrafi 1 i LSHPP-së që të tejkaloj kufijtë e kësaj procedure nën Nenin 36 paragrafi 1 i LSHPP-së, po ashtu edhe në mënyrë të palejueshme të përziej kompetencat e gjykatës sipas Nenit 35 paragrafi 7 në rastet kundër Vendimit Preliminar mbi legjitimitetin e shpronësimit me ato nën Nenin 36 paragrafi 6 i LSHPP-së, në raste për rregullimin e shumës së kompensimit të shpronësimit të përcaktuar me anë të Vendimit Përfundimtar. Kjo është pse të gjitha argumentet e ngritura nga propozuesit mbi mosbindjen me Nenin 4, paragrafi 1, nën-paragrafi 1-4 i LSHPP-së, duke ditur kufizimet e Nenit 36 paragrafi 1 i LSHPP-së, mund të mos konsiderohen fare në CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe nga kjo mund të mos parapërcaktohet drejtpërsëdrejti apo tërthorazi rezultati në këto lënde të bashkuara pasi që aktgjykimi i nxjerr për ato mund vetëm të rris/ zvogëloj shpronësimin e Vendimit Përfundimtar në pajtim me Nenin 36 paragrafi 6 i LSHPP-së. Kjo automatikisht përjashton të gjitha këto shkelje të pretenduara të Nenit 4, paragrafi 1, nën paragrafi 1-4 i LSHPP-së, si justifikim që të zëvendësohet masa e përkohshme e sigurisë e shqiptuar me 30 Korrik 2013 me ato të sigurisë sipas Nenit 306 paragrafi 3 i LSHPP-së lidhur me Nenin 3 të LPJ-së

Vendimi Përfundimtar nën Nenin 11 të LSHPP-së

14. Është prezantuar nga palët e kundërta, në kopje të shumta të përkatëse dhe të administruara në seancën dëgjimore të mbajtur me 19 Gusht 2013, Vendimi Përfundimtar Nr. 03/100 i Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 12 Nëntor 2012, në bazë të Nenit 92 paragrafi 4 dhe Nenit 93, paragrafi 4 i Kushtetutës, Nenit 11 dhe 45 të LSHPP-së, Nenit 4 të Rregullores Nr. 02/11 për sferat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, e ndryshuar me anë të Rregullores Nr. 07/11 dhe Nenit 19 të Rregullave të Procedurës Qeveritare, Nr. 09/2011. Me anë të pikës 1 të dispozitivit të saj është miratuar shpronësimi për interes publik të pronës së paluajtshme të Pronarëve dhe Zotëruesve të Interesit të prekur nga ndërtimi i magjistrales VËRMICË – MERDARE, Sektori 9, ZK Mazgit, e treguar në tabelat e bashkangjitura. E fundit në faqen 22, pikat 9-11 përfshinë si prona në emër të F. (H.) S.: 1) parcela kadastrale nr. 149-0, me sipërfaqe totale 1 262 m², prej së cilës

**AKTVENDIM CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 IGJYKATËS THEMELORE TË PRISHTINËS,
ME DATË 19.08.2013**

775 m² janë paraparë për magjistralen, gjersa të pa-shpronësuara kanë mbetur 487 m²;
2) parcela kadastrale nr. 150-0, me sipërfaqe totale 41775 m², prej se cilës 7655 m²
janë paraparë për magjistralen dhe 971 m² për rrugën N2, gjersa të pa-shpronësuara
kanë mbetur 33 149 m²; 3) parcela kadastrale nr. 152-0, me sipërfaqe totale 2 144 m²,
prej së cilës 725 m² janë paraparë për magjistralen dhe 390 m² për rrugën N2, gjersa
të pa-shpronësuara kanë mbetur 1029 m².

15. Vendimi Përfundimtar Nr. 03/100, i datës 12 Nëntor 2012 është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në bazë të kompetencave të saja të autoritetit të shpronësimit nën Nenin 2, paragrafi 1 dhe Nenit 4, paragrafi 3 të LSHPP-së, brenda periudhës kohore prej 12 muajve që ka filluar të vlejë në datën që përfshinë pesëmbëdhjetë (15) ditë pas datës efektive të Vendimit Preliminar Nr. 07/87 të datës 17 Gusht 2012 – 7 shtator 2012, në pajtim me Nenin 11, paragrafi 1, fjalia e parë e LSHPP-së. Ashtu që nuk ka dështim të organeve të shpronësimit që të përputhen me periudhën kohore nën Nenin 11, paragrafi 1 fjalia e parë dhe e dytë e LSHPP-së që mund të konsiderohet konform Nenit 11 paragrafi 11, fjalia e parë e LSHPP-së si Vendim Përfundimtar duke refuzuar kërkesën e shpronësimit në tërsinë e saj. Pasi që nuk ka pasur ankesa të ushtruara konform Nenit 35 të LSHPP-së në bazë të parcelës kadastrale nr.149-0, nr.150 dhe nr.152-0, ZK Mazgit, Vendimi Përfundimtar Nr. 03/100, i datës 12 Nëntor 2012 në pjesën e pronës së njëjtë janë lëshuar vetëm *për aspektet të pa ankimuar* të Vendimit Preliminar Nr. 07/87 të datës 17 Gusht në përputhshmëri me Nenin 11, paragrafi 3, fjalia e dytë e LSHPP-së. I pa cënueshëm është ndalimi i Nenit 11, paragrafi, fjalia e dytë e LSHPP-së, që organi i shpronësimit të mos e miratojë Vendimin Përfundimtar për pronat-subjekt i ankesave nën Nenin 35 të LSHPP-së, në pritje pranë gjykatës. Kështu që, nuk ka pasur urdhër të aplikueshëm të gjykatës apo aktgjykim nën Nenin 35 të LSHPP-së, Vendimi Përfundimtar Nr. 03/100 i datës 12 Nëntor 2012 do duhej të përputhej, sipas Nenit 11, paragrafi 4, nën paragrafi 1 i LSHPP-së lidhur me pjesët e parcelave kadastrale nr. 149-0, nr. 150 dhe nr. 152-0, të autorizuar për shpronësim me anë të Vendimit Preliminar Nr. 07/87 të datës 17 Gusht 2012. Tabelat dhe raportet e vlerësimit – pjesët integrale e Vendimit Përfundimtar Nr. 03/100 të datës 12 Nëntor 2012 sipas pikave 1 dhe 4 të dispozitivit

përmbajnë kushtet e përshkruara nga përmbajtja e saj të kërkuara nga Neni 11, paragrafi 4, nën paragrafi 2 i LSHPP-së. Përfshirë në pikën 7 të dispozitivit po ashtu është edhe deklarata e paraparë me Nenin 11, paragrafi 4, nën paragrafi 3 i LSHPP-së, për efektshemrin e këtij Vendimi Përfundimtar në datën e publikimit të tij në pajtim me Nenin 11, paragrafi 6 i LSHPP-së, në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në gazeta të përditshme të Kosovës. E dhëna në pikën 5 të dispozitivit është njoftimi nën Nenin 11, paragrafi 4, nën-paragrafi 3 i LSHPP-së që i udhëzon të gjithë personat të cilët posedojnë apo zotërojnë interes në pronën e paluajtshme apo të drejtat pronësore të prekura nga Vendimi Përfundimtar Nr. 03/100 i datës 12 Nëntor 2012 për të drejtën e tyre të ushtrojnë ankesë në gjykatë duke e ankimuar shumën e kompensimit të specifikuar në të, brenda 30 ditësh të hyrjes së saj në fuqi konform Nenit 36 të LSHPP-së.

16. Më 23 Nëntor 2012 Vendimi Përfundimtar Nr. 03/100 i datës 12 Nëntor 2012 është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe gazetën ditore (Koha Ditore) në përputhshmëri me Nenin 11, paragrafi 6 i LSHPP-së, kështu që duke hyrë në fuqi të njëjtën ditë konform Nenit 11 paragrafi 6 i LSHPP-së.

17. Shuma e kompensimit e përcaktuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme të Ministrisë së Financave në bazë të raporteve të vlerësimeve përkatëse të Kompanisë Konsulente "IMMOBILIA" e datës 6 Shtator 2012 – pjesët integrale të Vendimit Përfundimtar nr. 03/100 të datës 12 Nëntor 2012 është për si në vijim: 1) parcela kadastrale nr. 150-0 -775m², tokë – 23 250 Euro; 2) parcela kadastrale nr. 150-0 -7655 m², tokë – 191 375 Euro; 3) parcela kadastrale nr. 152-0 - 725 m², tokë – 30 450 Euro; ndërtesa 5 katesh -143 050 Euro (aktualisht nën masat e përkohshme të sigurisë); stalla – 1 250 Euro, bunari - 430 Euro; pemët kopshtore – 2 246 Euro. Në numërim të tërësishëm, kompensimi i specifikuar në Vendimin Përfundimtar Nr. 03/100 i datës 12 Nëntor 2012 për pronat e lartcekura të F. (H.) S. me orendi të tyre, pjesë shtesë dhe pemët arrin shumën totale prej **392 051 Euro**, e evidentuar me anë të formës tabelore të Zyrës për Vlerësim të Pronës së Paluajtshme të Ministrisë së Financave.

18. Pas këtij shpronësimi të parë të pjesshëm i dyti është miratuar për pjesë shtesë të parcelës kadastrale nr.150 dhe nr. 152 ZK Mazgit, e regjistruar në emrin e F. (H.) S. me anë të Vendimit Përfundimtar Nr. 06/130 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 16 Maj 2013, në bazë të Nenit 92 paragrafi 4 dhe Nenit 93, paragrafi 4 i Kushtetutës, Nenit 11 dhe 45 i LSHPP-së, Nenit 4 të Rregullores Nr. 02/11 për zonat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, e ndryshuar me anë të Rregullores, Nr. 07/11 dhe Nenit 19 të Rregullave të Procedurës Qeveritare, Nr. 09/2011. Siq shihet në tabelën përkatëse – e bashkangjitur këtij Vendimi Përfundimtar për pronat e F. (H.) S., nga parcelat kadastrale nr. 150-0, nr. 152-0, respektivisht 3 380 m² dhe 281 m² janë shpronësuar përpos kësaj për magjistralen. Me datë 30 Maj 2013, Vendimi Përfundimtar Nr. 06/130 i datës 16 Maj 2013 është publikuar në Gazetën Zyrtare dhe në gazetat e përditshme (Koha Ditore) në përputhshmëri me Nenin 11, paragrafi 6 i LSHPP-së, ashtu që ka hyre në fuqi konform Nenit 11 paragrafi 6 i LSHPP-së.

19. Shuma e kompensimit e përcaktuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme e Ministrisë së Financave në baze të raporteve shtesë të vlerësimeve përkatëse të Kompanisë Konsulente “IMMOBILIA” e datës 29 Prill 2013 – pjesët integrale të Vendimit Përfundimtar nr. 06/130 të datës 16 Maj 2013 janë për, si në vijim: 1) parcela kadastrale nr. 150-0 – 3380 m², tokë 84 500 Euro; ndërtesa 3 katëshe – 150 000 Euro; pemët – 814 Euro; rrethojat -850 Euro dhe bunari -700 Euro; dhe 2) parcela kadastrale nr. 152-0 – 281 m², tokë – 11802 Euro, bunari - 830 Euro dhe rrethojat e betonit - 320 Euro. Në numërim të tërësishëm kompensimi i specifikuar në Vendimin Përfundimtar Nr. 06/130 të datës 16 Maj 2013 për pronat e lartcekura të F. (H.) S. me orendi të tyre, pjesë anësore dhe pemët arrin në shumën totale prej **249 816 Euro**, e evidentuar me anë të formës tabelore të Zyrës për Vlerësim të Pronës së Paluajtshme të Ministrisë së Financave.

20. Kështu që shuma e kompensimit e specifikuar në Vendimin Përfundimtar Nr. 03/100 të datës 12 Nëntor 2012 po ashtu edhe Vendimi Përfundimtar i specifikuar Nr. 06/130 i datës 16 Maj 2013 konform Nenit 11, paragrafët 4.3.2.3 dhe Nenit 16 paragrafi 2, fjalia e parë e LSHPP-së si e paguar për pronat e shpronësuara në emër të

F. (H.) S., me orenditë e tyre, pjesët shtesë dhe pemët, duke qenë të dy të barabarta me shumat përkatëse të krijuara në vlerësimin e përcaktuar sipas Nenit 16 paragrafi 2, nën-paragrafi 1 i LSHPP-së, të akumuluar, mbledhur deri në shumën totale prej **641 867 Euro**. Ky numërim i kompensimit zyrtar në Vendimin Përfundimtar Nr. 03/100 të datës 12 Nëntor 2012 dhe Vendimit Përfundimtar Nr. 06/130 të datës 16 Maj 2013 për pjesë të shpronësuara të parcelës kadastrale nr.149-0, nr.150-0 dhe nr.152-0 është verifikuar me anë të një raporti përmbledhës të brendshëm të Sekretarit Gjeneral të MMPH-së për pagesën e tij saktësisht në këtë shumë të përgjithshme.

Pagesa e kompensimit sipas nenit 16 të LSHPP-së

21. Organi shpronësues është i obliguar që të paguaj shumën e përcaktuar zyrtarisht të kompensimit *Pronarëve dhe Zotëruesve të Interesit* – Neni 16, paragrafi 2, fjalia e parë e LSHPP-së. Nëse personi përkatës *refuzon* të pranoj një kompensim të tillë, duhet të vendoset në llogari të mirëbesimit në emrin e tij /saj në BQK sipas Nenit 16 paragrafi 3, fjalia e parë e LSHPP-së. E njëjta gjë, *nëse kontesti paraqitet lidhur me identitetin, ligjshmërisht posedon të drejtë që të pranojë pagesën për një kompensim të tillë*, ajo shumë duhet të depozitohet në BKQ, për përfituesin i cili ende nuk është caktuar, dhe kontesti i ushtruar në gjykatën kompetente për rizgjidhje sipas Nenit 16, paragrafi 3, fjalia e dytë e LSHPP-së. *Çdo shumë e vendosur në një llogari të tillë të mirëbesimit duhet të konsiderohet si e paguar për qëllime të këtij ligji* konform Neni 16 paragrafi 3, fjalia e tretë e LSHPP-së. Kjo pagesë është e vlefshme edhe nëse personi ushtron ankesë pranë gjykatës duke e sfiduar mjaftueshmërinë e kompensimit në Vendimin Përfundimtar- në veqanti, i pa-paragjykuar është autoriteti i gjykatës konform Neni 16, paragrafi 4, Neni 36, paragrafi 6 dhe paragrafi 8, fjalia e dytë e LSHPP-së, që të ri-kalkulohet shuma e specifikuar në Vendimin Përfundimtar, e depozituar në llogarinë e mirëbesimit dhe duke e rritur atë duke modifikuar Vendimin Përfundimtar dhe duke e ngritur atë me anë të modifikimit të Vendimit Përfundimtar dhe duke obliguar Organin shpronësues që të paguaj kompensim plotësues deri në shumën e diferencës.

22. Është vërtetuar se në procesin e shpronësimit propozuesit nuk i kanë siguruar organeve të shpronësimit të gjitha dokumentacionet e nevojshme për pagesë të kompensimit të shpronësimit nëpërmjet transfereve të rregullta në një apo më shumë llogari personale bankare në emrat e tyre. Dosja e plotë e shpronësimit e prezantuar nga Ministria e Drejtësisë nuk përmban Listat origjinale Poseduese apo Certifikata për të Drejtat e Pronës së Paluajtshëm, me vlefshmëri të pa skaduar prej 6 muajve, kopje të letërnjoftimit të A., H., B., D. dhe N. S., kopjen e kartelave bankare të tyre me numrat e ndonjë llogarie private bankare, certifikata e vdekjes e F. S. – origjinalen, dhe vendimi mbi rregullimin e trashëgimisë së tij – origjinali.

23. Përgjatë zhvillimit të procedurës së masave të sigurimit në seancën e mbajtur më 13 Gusht 2013, në bazë të deklaratave të përfaqësuesve të palëve, gjykata i ka dhënë mundësin që të arrijnë një marrëveshje Ligjore-shtesë rreth kushteve mbi lirimin e pronës së paluajtshme të shpronësuar. Lidhur me këtë përfaqësuesi i autorizuar i propozuesve ka deklaruar se të gjitha dokumentet e nevojshme për pagesë të kompensimit zyrtar të specifikuar në Vendimin Përfundimtar Nr. 03/100 i datës 12 nëntor 2012 dhe Vendimit Përfundimtar, Nr. 06/130 të datës 16 Maj 2013 do të prezantohet në MMPH brenda 3 ditësh, *inter alia*, numri i llogarisë bankare private i propozuesit (ve) për urdhërimin e transferimit direkt të shumës totale prej 641 867 Euro. Në seancën e ardhshme të mbajtur me 19 Gusht 2013 është bërë e qartë se këto dokumente nuk janë dorëzuar në MMPH, gjatë shtyrjes/ zgjatjes, pavarësisht mundësisë së dhënë nga gjykata dhe po ashtu gatishmërisë së kundër-propozuesit për pagesë të menjëhershme të shumës totale prej 641 867 Euro në llogarinë personale bankare të propozuesve. Me tej, përfaqësuesit e tyre, po ashtu edhe A., H., B., dhe D. S. kanë deklaruar në seancën e datës 19 Gusht 2013 *refuzimin* e tyre që të pranojnë kompensimin e specifikuar në Vendimin Përfundimtar Nr. 06/130 të datës 16 Maj 2013, në shumën totale prej 641 867 Euro. Refuzimi duke qenë i përgjithshëm i referohet po ashtu edhe pjesës prej 143 050 Euro, të përcaktuar në baze të vlerësimit të ndërtesës 5 kateshe në parcelën katastrale, nr.152-0 ZK Mazgit, tani nën masat e përkohshëm të sigurisë që parandalon shkatërrimin e saj.

24. Duke pasur parasysh *refuzimin* e propozuesve që të pranojnë 641 867 Euro si shumë totale të kompensimit të specifikuar në Vendimin Përfundimtar Nr. 03/100 të datës 12 Nëntor 2012 dhe Vendimit Përfundimtar Nr. 06/130 të datës 16 Maj 2013, *mund të mos u paguhet atyre drejtpërsëdrejti nga organet e shpronësimit si Pronarë të prekur apo Zotërues të Interesit në pajtim me Nenin 16, paragrafi 2, fjalia e parë e LSHPP-së*. Propozuesit janë në vonese të kreditorëve në nenin 325 paragrafi 1 i Ligjit i marrëdhënieve detyrimore (Gazeta Zyrtare e RSFJ-se, Nr. 29/78) me ndryshime Nr. 39/85, 45/89, 57/89 dhe Gazetës Zyrtare të RFJ-se Nr. 31/93) (“LMD”) duke refuzuar pa baze të justifikuar që të pranojnë përmbushjet e ofruara nga organet e shpronësimit si debitor dhe duke parandaluar nëpërmjet sjelljes së tyre një përmbushje të tille nëpërmjet pagesës direkte të shumës së kompensimit në llogarit e tyre personale bankare sipas nenit 16, paragrafi 2, fjalia e parë e LSHPP-se dhe Nenit 305, paragrafi 1, hipoteza e parë e LMD. Duke ditur këtë vonese të kreditorëve shkalla e interesit është ndalur se ecuri konform Nenit 326, paragrafi 2 i LMD-së dhe nga kjo nuk mund të konsiderohet si rrjedhojë konform Nenit 16 paragrafi 2, nën paragrafi 2 i LSHPP-së.

25. Sikurse që është evidentuar me anë të parashtrësës së avokatit A. K., të datës 15 Gusht 2013 dhe skemave jo zyrtare të bashkangjitura me to, dhe deklaratës së tij në seancën e 19 Gushtit 2013, secila padi e propozuesve mbi pronësinë e pronës së paluajtshme të pjesëve të parcelës kadastrale nr.149-0, nr.150-0 dhe nr.152-0, megjithatë, pa ndonjë dokument për një ndarje fizike të tille dhe/ose titujt përgjegjës të pronës individuale, duke i legjitimuar ato si Pronarë apo Zotërues të Interesit. Si përfitues të kompensimit për shpronësimin e tyre të specifikuar në Vendimin Përfundimtar Nr.03/100 i datës 12 Nëntor 2012 dhe Vendimit Përfundimtar Nr. 06/130 i datës 16 Maj 2013 nuk është i ditur dhe nuk është i sigurt, e përjashtuar është mundësia për depozitim të shumës së tyre në llogarinë e mirëbesimit në emrin e njërit apo me shumë propozuesve në BQK, konform nenit 16, paragrafi 3, fjalia e parë e LSHPP-se. Pasi që ekziston kontesti që vjen për shkak të identitetit të personave, që ligjërisht kanë të drejte që të pranojnë pagesën e kompensimit, apo pjese nga kjo, mundësia e vetme e mbetur është që e tere shuma të depozitohet në llogarinë e

mirëbesimit në BQK për përfitim që ende duhet të përcaktohet nëpërmjet procedurës gjyqësore konform nenit 16, paragrafi 3 fjalia e dyte e LSHPP-se

26. E evidentuar përmes dokumenteve zyrtare me efekt dëshmuës detyruës nën Nenin 329, paragrafi 1 i LPK-së i lidhur me Nenin 3 të LPJ-së, e prezantuar nga Ministria e Drejtësisë dhe e kërkuar konform Nenit 322 të LPK-së e lidhur me Nenin 3 të LPJ-së, nga BQK-ja, të gjitha të administruara në procedure të masave të sigurimit, MMPH ka vepruar në pajtim me Nenin 16, paragrafi 3, fjalia e dytë e LSHPP-së. Në llogarinë e mirëbesimit Nr. xxxxxxxxxxxx e hapur në BQK nga Ministria e Financave për fondet e shpronësimit në mirëbesim (shkresa ref. Nr. 1923/1 e BQK e datës 16 Gusht 2013), pas kërkesës së MAPH për pagese të kompensimit nëpërmjet kësaj llogarie nën protokoll nr.2077 të datës 13 Qershor 2013 me anë të urdhër pagesës ref. nr. 2101131263 të Ministrisë së Financave e datës 18 Qershor 2013 në të, janë transferuar 641 867 për pagese të kompensimit për pronat e F. S.. Kështu që kjo shume është specifikuar në Vendimin Përfundimtar Nr. 03/100 i datës 12 Nëntor 2012 dhe Vendimit Përfundimtar Nr. 06/130 i datës 16 Maj 2013 është depozituar plotësisht në llogarinë e mirëbesimit në BQK në pajtim me Nenin 16, paragrafi 3, fjalia e dytë e LSHPP-se. Si përfitues i shumës, apo përfituesit e pjesëve prej saj, *ende e pa përcaktuar nga procedura gjyqësore*, është depozituar në llogarinë e mirëbesimit e administruar nga Ministria e Financave në kuadër të kompetencës ekskluzive të paguaj aktgjykimin e ardhshëm final sipas Nenit 40, paragrafi 1 dhe 3 të LMFPP jashtë përvetësimit, tani më të transferuar me anë të buxhetit për kompensim e pronave të F. S. në shumën e 641 867 Euro. Sikurse që është sqaruar me anë të shkresës ref.nr.1923/1 të BQK-së, të datës 16 Gusht 2013, kjo është si rrjedhojë ndaj kufizimit të Nenit 40, paragrafi 2, fjalia e parë (i) LMFPP, të gjitha pagesat e aktgjykimit të gjykatës dhe urdhëresat të jone efektive nëpërmjet llogarisë së vetme të mirëbesimit dhe ndalesa e Nenit 40, paragrafi 2, fjalia e parë (ii) LMFPP, as BQK e as ndonjë bankë tjetër, autoriteti publik apo personi përveç Ministrisë së Financave që të ndërmerri ndonjë veprim për implementimin e një aktgjykimi të tillë apo urdhërese, duke përfshirë pagesat në përmbushje të tyre.

27. Prandaj shuma e kompensimit e specifikuar në Vendimin Përfundimtar Nr. 03/100 i datës 12 Nëntor 2012 dhe Vendimit Përfundimtar Nr. 06/130 i datës 16 Maj 2013 për shpronësim të pronës të F. S. – 392 051 Euro dhe 249 816 Euro, respektivisht, në total 641 867 Eurove janë depozituar më **18 Qershor 2013** nga MMPH në llogarinë e mirëbesimit Nr. xxxxxxxxxx - *fondet e shpronësimit në mirëbesim* – në BQK, me këtë justifikim të qartë ashtu që Ministria e Financave konform Nenit 40, paragrafi 1 dhe 2 të LMFPF-se do të zbatonte aktgjykimin final të ardhshëm duke përcaktuar përfitimin e përfituesve të kësaj shume duke e urdhëruar pagesën e saj jashtë këtyre ndarjeve tashmë të transferuara dhe në dispozicion për këtë qëllim përmes sistemit të Llogarisë së Vetme të Thesarit. Nga depozitimi i këtyre 641 867 Eurove në llogarinë e mirëbesimit Nr. xxxxxxxxxx në BQK për pagesën e kompensimit për pronat e shpronësuara të F. S. një përfituesi ose përfituesve, kërkesa e Nenit 16, paragrafi 3, fjalia e dytë e LSHPP është përmbushur. Këto 641 867 Euro të depozituara në një llogari të tillë të mirëbesimit në BQK në pajtim me Nenin 16, paragrafi 3, fjalia e dytë e LSHPP-së do të konsiderohet se kanë qenë e "*paguar*" për qëllimet e LSHPP-së me datë 18 Qershor, 2013.

Skadimi i afatit kohor për lirimin e pronës sipas Nenit 11, paragrafe 9 i LSHPP-së

28. Neni 11, paragrafi 9, nën-paragrafi 1 i LSHPP-së thekson se personat të cilët janë pronarë ose posedues të pronës në fjalë, nuk do të detyrohen që ta lirojnë ose dorëzojnë pronën përpos në rast se ndërtesa është shfrytëzuar në mënyrë aktive për çështje banimi, 20 ditë kanë kaluar nga data në të cilën kompensimi i përcaktuar në Vendimin Përfundimtar ka qenë i paguar në përputhje me Nenin 16 të LSHPP-së.

29. Duke qenë e përfshirë në depozitën e lartpërmendur prej 641 867 Eurosh, vënë në xhirollogarinë e mirëbesimit Nr. xxxxxxxx në BQK për pagesën e kompensimit për pronat e shpronësuara të F. S., pjesa prej 143 050 Eurosh e përcaktuara në Vendimin Përfundimtar Nr.03/100, e datës 12 Nëntor 2012 për ndërtimin në ngastrën kadastrale nr.152-0, duhet të konsiderohet po ashtu e paguar në pajtim me Nenin 16, paragrafi 3, fjalia e dytë dhe e tretë e LSHPP-së me datë 18 Qershor 2013. Në datën e kësaj pagese, afati kohor prej 20-ditësh i përcaktuar me Nenin 11, paragrafi 9, nën-paragrafi

1 i LSHPP-së në këtë moment ka filluar për lirim e ndërtesave të banimit në ngastrën kadastrale nr.152-0 nga pronari (ët) e saj dhe poseduesit dhe pa u ndërprerë apo pushuar, ka mbaruar me 8 Korrik 2013. Me mbarimin e kësaj periudhe të zbatueshme sipas Nenit 11, paragrafi 9, nën-paragrafi 1i LSHPP-së, *Organi Shpronësues e ka fituar të drejtën për të marrë posedimin e kësaj prone në pajtim me Nenin 25 LSHPP.*

Strehimi i përkohshëm sipas Nenit 20 të LSHPP-së

30. Sipas Nenit 20, fjalia e pare e LSHPP-së në rast të shpronësimit të një ndërtese që është *ndërtuar në mënyrë të ligjshme* dhe shfrytëzuar për banim, Organi Shpronësues do t'u sigurojë banorëve strehime të përkohshëm për periudhën deri në 4 muaj pas mbarimit të periudhës kohore të parashikuar në Nenin 11, paragrafi 9 LSHPP-së, nëse nuk është rënë dakord ndryshe.

31. Ishte pranua nga propozuesit në seancën e datës 19 Gusht 2013 sipas Nenit 321, paragrafi 2 LPK në lidhje me Nenin 3 LPJ-së se shtëpia në ngastrën kadastrale nr.152-0 ka qenë ndërtuar *pa leje ndërtimi* të lëshuar nga Komuna e Obiliqit. Për këtë arsye, *ajo nuk mund të konsiderohet ligjërisht e ndërtuar*, e cila automatikisht përjashton aplikimin e Nenit 20 LSHPP-së—Organi i Shpronësimit nuk është i detyruar me dispozita për të siguruar për banorët e kësaj shtëpie ndonjë akomodim të përkohshëm për çdo kohëzgjatje. Duke mos qenë zyrtarisht të obliguar për të vazhduar sipas Nenit 20 LSHPP, the MMPH ndërmori hapa për të gjetur banesa të reja për familjet që jetojnë në këtë ndërtesë. Dëshmuar nga Fletë Dërgesa nr.ref.1085, i datës 16 Korrik 2013 një komision i zyrtarëve të MMPH-së vizitoi Obiliqin, kontaktoi një agjenci të pasurive të patundshme atje, inspektohen dy shtëpi dhe dy banesa të ofruara prej saj dhe zgjodhi një apartament në Prishtinë si të përshtatshme për nevojat e familjes S. Siq shihet nga Fletë Dërgesat e datës 18 dhe 22 Korrik 2013, Departamenti i Shpronësimit i MMPH-së ka vazhduar për të kërkuar në treg, kontaktuar agjencitë e pasurive të patundshme, ka pasur negociata por në fund ka mundur të zgjedhi një banesë apo shtëpi me qira. Nga Fletë Dërgesa e datës 22 Korrik

**AKTVENDIM CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 IGJYKATËS THEMELORE TË PRISHTINËS,
ME DATË 19.08.2013**

2013 e MMPH-së është miratuar si një zgjidhje e problemit të strehimit të familjes S., përfundimi i një kontrate me Hotel "A." në Sllatinë të Madhe.

32. Me datë 22 Korrik 2013, MMPH si Qiramarrëse dhe NTSH "A." – Prishtinë si Qiradhënëse lidhën Kontratën mbi Dhënien me Qira të Ndërtesës - Dhomave në Hotel "A.". Ishte bërë marrëveshja që Qiradhënësi të ia japi me qira qiramarrësit dhomat në hotel për personat, siq janë konkretizuar nga një urdhër i posaçëm nga Departamenti i Shpronësimit të MMPH-së më çmim prej 10 Eurosh në ditë për person. Po ashtu qe dakorduar që marrëdhënia e qirasë të fillojë me 22 Korrik 2013 dhe të përfundojë me 31 Dhjetor 2013. Kopja e kësaj kontrate u është shërbyer propozuesve me datë 2 Gusht 2013 si një shtojcë e parashtresës ref.nr.1317 të Ministrisë së Drejtësisë, të datës 2 Gusht, 2013. Në seancën e datës 13 Gusht 2103, Zyrtar i Lartë Ligjor SH. H. nga Ministria e Drejtësisë deklaroi në emër të kundër-propozuesve në prani të përfaqësuesit të propozuesve se në bazë të kësaj kontrate të datës 22 Korrik 2013 me afat të vlefshmërisë që akoma nuk kishte skaduar, se Hotel "A." mbetet i ofruar si një strehim i përkohshëm në dhomat e saja për të gjithë anëtarët e familjes që tani jetojnë në shtëpi në ngastrën kadastrale nr.152-0. Kjo deklaratë, regjistruar në procesverbalin e seancës së datës 13 Gusht 2013 sipas Nenit 135, paragrafi 2 i LPK-së në lidhje me Nenin 3 të LPJ-së, nënshkruar nga përfaqësuesi i propozuesve, pa kundërshtime, të shërbejë si një njoftim i kundër-propozuesve për propozuesit për strehimin e ofruar në Hotel "A.". Mos-pranimi i saj nga propozuesit pa ndonjë arsyetim të bazuar i vendos të gjithë ata në vonesa të kreditorit sipas Nenit 325, paragrafi 1 i LMD, e cila e shkarkon në pajtim me Nenin 326, paragrafi 1 i LMD-së Organin e Shpronësimit nga ndonjë vonesë në përmbushjen e detyrimit të përcaktuar nga Neni 20 i LSHPP-së për të siguruar një strehim të përkohshëm.

33. Bazuar në deklaratat e përfaqësuesve të palëve në seancën e datës 13 Gusht 2103, ajo është shtyrë, *inter alia* me qëllim që propozuesit të gjenin vetë një strehim të ri, që do kënaqte nevojat e tyre kryesore të banimit, me qira të arsyeshme dhe që t'a informonin MMPH për miratimin dhe përfundimin e kësaj kontrateje të qirasë. Megjithatë, gjatë shtyrjes së seancës mbi masën e sigurimit në pajtim me Nenin 438,

paragrafi 1 i LPK-së në lidhje me Nenin 3 të LPJ-së, propozuesit nuk kanë gjetur vetë ndonjë shtëpi apo banesë për tu marrë me qira si strehim i tyre i përkohshëm, pasi kanë liruar shtëpinë-vendbanimin e tyre të tanishëm, e as nuk e kanë informuar MMHP-në për dhënien me qira të saj në procedurën përkatëse të standardizuar.

34. Kushti shtesë për lirim të një ndërtese të shpronësuar të banimit e përdorur për banim, e ndërtuar *ligjërisht* siq është dhënë nga Neni 20 LSHPP-së si një detyrim që Organet e Shpronësimit t'u sigurojnë të gjithë banorëve një strehim të përkohshëm nuk është *i zbatueshëm* këtu meqë shtëpia në ngastrën kadastrale nr.152-0 ka qenë e ndërtuar në mënyrë të paligjshme, pa leje. Edhe pse jo zyrtarisht i detyrueshëm në këto rrethana, Neni 20 LSHPP-së ka qenë *de facto* në pajtueshmëri me nga MMPH-në me përfundimin e një marrëveshjeje qiraje të përgjithshme me Hotel "A." me datë 22 Korrik 2013 duke lejuar menjëherë akomodimin e të gjitha familjeve që jetojnë në ndërtesën në ngastrën kadastrale nr.152-0 në ambientet e hotelit për një afat prej 4-muajsh. Mospranimi i këtij propozimi pa ndonjë arsytim të bazuar dhe mos dhënia e ndihmës në gjetjen e ndonjë banese tjetër alternative nga familja S., si vonesë e kreditorit, nuk e shuajnë përbushjen e Nenit 20 të LSHPP-së nga Organi për Shpronësim, pa qenë të detyruar të përbushin atë.

Neni 36, paragrafi 8, fjalia e parë LSHPP

35. Sipas Nenit 36, paragrafi 8, LSHPP, fjalia e parë, as paraqitja e ankesës ndaj aktgjyqimit sipas Nenit 36, paragrafi 1 LSHPP as paraqitja e apelit kundër aktgjyqimit të shkallës së parë sipas Nenit 36, paragrafi 7 LSHPP nuk ndikon në efektivitetin e këtij aktgjykimi ose të drejtën e Organit Shpronësues që të vazhdojë zbatimin e vendimit përkatës. Ky kufizim eksplicit i domosdoshëm në pajtim me Nenin 39, paragrafi 1 i LSHPP-së mbizotëron mbi çdo normë kontradiktore të ndonjë ligji tjetër procedural. Konsekuente të kufizimit dhe supremacinë e saj mbi dispozitat e Kapitullit XXI LPK, gjykata mund të ndalojë zbatimin e Vendim Nr.03/100, të datës 12 Nëntor 2012, duke e ndaluar rrënimin e shtëpisë në ngastrën kadastrale nr.152-0 vetëm nëse të gjitha kushtet e parashikuara nga ligji për zbatimin e kësaj, janë evidentuar si të përbushura rregullisht. Përkundrazi, gjykata nuk mund të autorizojë

**AKTVENDIM CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 IGJYKATËS THEMELORE TË PRISHTINËS,
ME DATË 19.08.2013**

asnjë masë sigurie përtej këtij kufiri, sepse kjo do të pezullonte zbatimin e Vendim Nr.03/100, të datës 12 Nëntor 2012 në kundërshtim me Nenin 36, paragrafi 8 LSHPP fjalia e parë, e cila përjashton çdo ndikim të procedimit gjyqësor të tanishëm mbi efektivitetin e saj, duke përfshirë pezullimin direkt/indirekt, dhe pa kushte garanton kompetencat e Organit Shpronësues për të vazhduar me ndërtimin e autostradës si një projekt kombëtar infrastrukturor në interes publik. Duke mos i tejkaluar kufijtë e Nenit 36, paragrafi 8, LSHPP, fjalia e parë me aktvendimet CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 të Gjykatës Themelore të Prishtinës me datë 30 Korrik 2013, rrënimi i shtëpisë në ngastrës kadastrale nr.152-0, ZK Mazgit ishte i ndaluar *vetëm* deri sa kushtet e përcaktuara në ligjin për zbatimin e aktgjykimit Nr.03/100, të datës 12 Nëntor 2012 të jenë plotësuar. Nga provat e administruara në seancë sipas Nenit 306, paragrafi 2 LPK, në lidhje me Nenin 3 LPJ-së është provuar miratimi i Vendimit Paraprak Nr. 07/87, i datës 17 Gusht 2012, sipas Nenit 10 LSHPP dhe Vendimi Përfundimtar Nr.03/100, të datës 12 Nëntor 2012 sipas Nenit 11 LSHPP, efektiviteti i tyre pas publikimeve sipas Nenit 43 LSHPP, pagesa e kompensimit e përcaktuara në këtë Vendim Përfundimtar sipas Nenit 16, paragrafi 3, fjalia e dytë dhe e tretë LSHPP nëpërmjet depozitimit në një llogari të mirëbesimit në BQK më 18 Qershor 2013, skadimi me datë 8 Korrik 2013 i periudhës 20-ditëshe, pas kësaj pagese, i vendosur për lirim të pronës nga Neni 11, paragrafi 9, nën-paragrafi 1 LSHPP, dhe gjithashtu një strehim i përkohshëm siq është dhënë që nga data 22 Korrik 2013, pavarësisht nga mos-zbatueshmëria e Nenit 20 LSHPP. Me një konformitet të tillë të konstatuar ndërtesa e banimit në parcelën kadastrale nr.152-0, ZK Mazgit është transferuar nga pronësia privatë në atë shtetërore sipas Nenit 4, paragrafe 5 dhe Neni 26 i LSHPP-së, me të drejtën e Organit Shpronësues që pas datës 8 Korrik 2013 ta marrë posedimin e saj sipas Nenit 11, paragrafe 9, nën-paragrafi 1 dhe Neni 25 i LSHPP-së. Duke qenë të urdhëruar me kohëzgjatje brenda kufijve të Nenit 36, paragrafi 8, fjalia e parë LSHPP, masa e përkohshme e sigurisë sipas Nenit 306, paragrafi 1 LPK, në lidhje me Nenin 3 LPJ, nuk mund të zëvendësohet nga një masë e sigurisë sipas Nenit 306, paragrafi 1 i LPK-së, lidhje me N 3 të LPJ-së – ndalesa që ndërtesa e banimi në parcelën kadastrale nr.152-0, ZK Mazgit të rrënohet derisa kushtet e zbatueshme të specifikuara nga i

njëjti ligj për zbatimin e Vendim Nr. 03/100, të datës 12 Nëntor 2012, në pjesën përkatëse të jenë evidentuar si të përmbushura në mënyrë të rregullt dhe rasti nuk mund të pezullohet pasi që një pajtueshmëri e tillë është provuar në procedurë. Masa e përkohshme e sigurisë nuk mund të konvertohet në një të sigurisë në bazë të Nenit 306, paragrafi 3 i LPK-së në lidhje me Nenin 3 të LSHPP-së pasi kjo do të komprometojë efektivitetin e Vendimit Përfundimtar Nr.03/100, të datës 12 Nëntor 2012 dhe të bllokojnë zbatimin e saj për një periudhë të papërcaktuar kohore kundërshtim me Nenin 36, paragrafi 8, LSHPP, fjalia e parë e cila e ndalon ndërprerjen e tillë.

36. Mirëmbajtja e sigurisë nuk është justifikuar sipas Nenit 297, paragrafi 1, pika b) e LPK-së, në lidhje me Nenin 3 të LPJ-së meqë rrënimi i ndërtesës në ngastrën kadastrale nr.152-0, pas raportit të ekspertëve të siguruar si dëshmi në CN .nr.308/13 të Gjykatës Themelore të Prishtinës, me përshkrim të plotë të karakteristikave të saja dhe matjeve të sipërfaqeve të saja, mund ta bëj përcaktimin e kompensimit për shpronësim të saj ose zbatimin e Aktgjykimit sipas Nenit 36, paragrafi 6 i LSHPP-së të pamundur ose tepër të vështirë. Më tej, nuk ka asnjë rrezik që gjendja ekzistuese do të ndryshohet me rrënimin e shtëpisë në ngastrën kadastrale nr.152-0 pa plotësimin paraprak të të gjitha kushteve ligjore të përcaktuara për transferimin e pronësisë së saj dhe lirim dhe/apo të drejtën e propozuesit (ve) të kompensohen në mënyrë adekuate për shpronësimin e saj, do të ndikohet negativisht.

37. Siguria nuk mund të arsyetohet më tej nga ndonjë prej argumenteve që pretendohen në paraqitjen e avokatit A. K., me datë 15 Gusht 2013. Në rradhë të parë, pretendimet se *ngastra kadastrale nr.149-0* me sipërfaqe të përgjithshme prej 1 262 m² është shpronësuar në pjesën e 775 m², ndërsa mbetja prej 487 m² ishte *de facto* e marrë pa shpronësim janë të parëndësishme për masën e sigurisë së përkohshme të caktuar në lidhje me ndërtesën në *ngastrën kadastrale nr.152-0*. Përveç kësaj, në pajtim me Nenin 36, paragrafi 6 i LSHPP-së në këtë procedurë gjykata është e autorizuar vetëm për të bërë ri-llogaritjen e kompensimit të përcaktuar në Vendimin Përfundimtar për pronat e paluajtshme të shpronësuara *formalisht* sipas Nenit 3, paragrafi 2, fjalia e parë LSHPP. *Jashtë fushëveprimit* të kësaj procedure,

**AKTVENDIM CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 IGJYKATËS THEMELORE TË PRISHTINËS,
ME DATË 19.08.2013**

megjithatë, sipas Nenit 3, paragrafi 2, fjalia e dytë e LSHPP-së a janë të gjitha pretendimet duke kërkuar kompensim për humbjet e shkaktuara nga masat apo aktet, ose nga një sërë masash dhe aktesh, të marra ose të miratuara nga një ose më shumë autoritete publike me efekt, në thelb ekuivalente me shpronësimin, që duhet të depozitohet në një procedurë kontestimore dhe nuk mund të të inkorporohen në procedimin e tanishëm jokontestimor sipas Nenit 36 LSHPP në lidhshmëri me Nenet 215–222 të LPJ-së. Mospërputhjet në mes të pjesëve të shpronësuara *formalisht* të tokës dhe ato *de facto* të përdorura për ndërtim nuk mund të vendosen në këtë procedurë të kufizuar nga Neni 36, paragrafi 1 LSHPP në fushëveprimin e saj për rregullimin e kompensimit vetëm për pronat e shpronësuara *de jure*. *Së dyti*, vlerësimi i pjesëve të shpronësuara të ngastrave kadastrale nr. 149-0, nr 150-0 dhe nr.152-0, me kulturë-tokë bujqësore, duke pasur si përdorim aktual – parcela të tokës për ndërtesa banimi mund të rishikohet vetëm në procedimin kryesor në CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 të Gjykatës Themelore të Prishtinës, duke qenë të parëndësishme në procedimin e sigurisë aksesoriale sipas Nenit 306 të LPK-së në lidhje me Nenin 3 të LPJ-së, kufizuar për rrënimin e shtëpisë së ndërtuar në ngastrën kadastrale nr.152-0. Për më tepër, realizimi i punimeve të ndërtimit në autostradë, në sipërfaqet e shpronësuara të parcelave kadastrale nr.149-0, nr.150 dhe nr.152-0-0 nuk do të bëjë të pamundur, as nuk do të pengojë ndjeshëm vlerësimin në *ngastrat tokësore* të prekura *përveç ndërtesës* së siguruar tani. *Së treti*, me anë të ekspertizës së emëruar në CN.nr.308/13 të Gjykatës Themelore të Prishtinës me gjetjen dhe mendimin e paraqitur në lidhje me rastin, dhe ekzaminimin e ekspertit në seancën e datës 25 Qershor 2013, kjo dëshmi ka qenë e siguruar sipas Nenit 385, paragrafi 1 i LPK-së në lidhje me Nenin 3 të LPJ-së, dhe do të inkorporohet në pajtim me Nenin 385, paragrafi 2 i LPK-së në lidhje me Nenin 3 të LPJ-së në CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 të Gjykatës Themelore të Prishtinës, pa nevojën për t’u ri-administruar. Prandaj, matjet e ndërtesës në ngastrën kadastrale nr.152-0 të marra me këtë ekspertizë mund të ballafaqohen me ato në raportin e vlerësimi të Ministrisë së Financave, të datës 6 Shtator 2012. Meqë dallimet në sipërfaqet janë dokumentuar tashmë, mos-rrënimi i shtëpisë nuk është i nevojshëm për të përcaktuar këto mospërputhje përsëri. *Së katërti*,

jo-shpronësimi i supozuar prej 800 m², tre puse të ujit dhe drunjtë frutorë në ngastrat kadastrale nr.150 dhe nr.152-0-0 në afërsi me kufirin e vijës së kuqe të shpronësimit, të magjistrales, nuk mund të vendoset në këtë procedurë në bazë të Nenit 36 të LSHPP-së, duke pasur parasysh kufizimet e subjektit të saj për kompensim për pronat e shpronësuara, as nuk mund të justifikojë rrënimin mos-rrënimin e ardhshëm të ndërtesës në ngastrën kadastrale nr.152-0. Asnjë interes i sigurisë nuk mund të arsyetohet dhe asnjë masë e propozuar për ruajtjen e instalimeve përkatëse, pjesëve shtesë dhe frutave dhe/apo për të identifikuar ndonjë dëmtim të demonstrueshëm të drejtpërdrejtë të shkaktuar gjatë procesit të shpronësimit, të lokalizuara në parcelat nr.149, nr.150-0-0 dhe nr.152-0, në funksion të sigurimit eventual të ardhshëm të Nenit 15, paragrafi 2 i LSHPP-së. *Së pesti*, masa e përkohshme e sigurisë nuk mund të ruhet deri në përfundimin e një shpronësimi të drejtë, të saktë, të paanshëm, jo-diskriminues bazuar në vlerën e tregut e cila është kërkesa e parë në petitumin e parashtresës me datë 15 Gusht 2013. Kjo do të thotë që mos-rrënimi i urdhëruar të pezullohet gjer në lëshimin e një aktgjykimi final të lëshuar në shkallë të parë sipas Nenit 36, paragrafi 6 i LSHPP-së apo në shkallë të dytë sipas Nenit 36, paragrafe 7 i LSHPP-së. Megjithatë, siguria nuk mund të urdhërohet derisa një përfundim i tillë i kontestit për kompensim të shpronësimit, pasi kjo do të thotë zbatimin e Vendimit Përfundimtar Nr. 03/100, të datës 12 Nëntor 2012 të suspendohet për një periudhë kohore të pacaktuar në shkelje të Nenit 36, paragrafi 8, LSHPP fjalía e parë, duke ndaluar çdo efekt të procedurës gjyqësore sipas Nenit 36, paragrafët 1 - 7 LSHPP mbi efektivitetin ndaj këtij Vendimi Përfundimtar, duke përfshirë edhe pezullimin e pjesshëm përmes sigurisë së përkohshme. E palejueshme është edhe kërkesa e dytë në parashtresën e datës 15 Gusht 2013, që masa të mbetet në fuqi deri sa shpronësimi i pronave të paluajtshme të anulohet për parregullsi ligjore dhe të fillojë nga fillimi. Siq është theksuar më lartë A., H., B. dhe D. S. kanë dështuar për të paraqitur një ankesë sipas Nenit 35, paragrafi 1 i LSHPP-së kundër Vendimit Preliminar Nr. 07/87, të datës 17 Gusht 2012 brenda afatit 30-ditor të përcaktuar me Nenin 35, paragrafe 1 i LSHPP-së- pasi një procedim i tillë mbi legjitimitetin e shpronësimit nuk është iniciuar, ka qenë e përjashtuar mundësia për ndërprerjen e saj ose modifikim të

**AKTVENDIM CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 IGJYKATËS THEMELORE TË PRISHTINËS,
ME DATË 19.08.2013**

fushëveprimit të saj duke përjashtuar pronën e caktuar ose të drejtat nga një aktgjykim i lëshuari në pajtim me Nenin 35, paragrafi 7, nën-paragrafi 1-2 i LSHPP-së. Brenda këtij procesi aktual sipas Nenit 36, paragrafi 1 LSHPP për të sfiduar përshtatshmërinë e kompensimit, të përcaktuar në vendimin përfundimtar, gjykata vetëm mund të *ri-llogaris shumën e saj* sipas Nenit 36, paragrafi 6 LSHPP, por jo të anulojë shpronësimin dhe të urdhërojë përsëritjen e saj nga fillimi. Pasi një aktgjykim i tillë nuk mund të lëshohet në CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 të Gjykatës Themelore të Prishtinës, proceduralisht kjo nuk është e lejueshme që masa e përkohshme e sigurisë të zgjasë deri në lëshimin e saj të pamundur.

38. Masa e përkohshme e sigurisë e caktuar në bazë të Nenit 306, paragrafi 1 në lidhje me Nenin 3 të LPJ-së me aktvendimin CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 të Gjykatës Themelore të Prishtinës me datë 30 Korrik 2013, pas seancës së mbajtur në pajtim me Nenin 306, paragrafi 2 në lidhje me nenin 3 të LPJ-së do të anulohet nga ky aktvendim sipas Nenit 306, paragrafi 3, në lidhje me nenin 3 të LPJ-së - meqë kushtet ligjore sipas Neneve 10, 11, 16, 20, 25 dhe 26 të LSHPP-së për zbatimin e Vendimit Përfundimtar Nr.03/100, të datës 12 Nëntor 2012 janë plotësuar në rastin në lidhje me ndërtimin e ndërtesës pesëkatëshe të banimit në parcelën kadastrale nr.152-0 dhe nuk ka asnjë pengesë për transferimin e pronësisë private mbi të dhe për dorëzimin e posedimit të saj tek Organet për Shpronësim, modalitetet e masës janë paraqitur, ndërsa mirëmbajtja e mëtejshme e saj nuk është më e justifikueshme me ndonjë pengesë në përcaktimin e kompensimit për shpronësim të saj apo vështirësi në zbatimin e vendimit të dhënë në përputhje me Nenin 36, paragrafi 6 i LSHPP-së. Në mënyrë që të garantojë efektivitetin e Vendimit Përfundimtar Nr. 03/100, me datë 12 Nëntor 2012 dhe implementimin e saj edhe më tej në bazë të Nenit 36, paragrafi 8, fjalia e parë e LSHPP-së, masa e përkohshme e sigurisë e urdhëruar me datë 30 Korrik 2013 do të anulohet me efekt të menjëhershëm në pajtim me Nenin 306, paragrafi 3 i LPK-së në lidhje me Nenin 3 të LPJ-së.

39. Në mënyrë që të garantohet efektiviteti i Vendimit Përfundimtar Nr. 03/100, e datës 12 nëntor 2012 dhe implementimin e saj të mëtejme sipas Nenit 36, paragrafi 8, fjalia e parë LSHPP-së, masa e përkohshme e sigurisë urdhëruar me 30 korrik 2013

**AKTVENDIM CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 IGJYKATËS THEMELORE TË PRISHTINËS,
ME DATË 19.08.2013**

duhet te anulohet me efekt te menjeshem sipas Nenit 306, paragrafi 3 i LPK lidhur me Nenin 3 te LJP.

Në funksion të arsyetimit të mësipërm është vendosur si në dispozitiv.

KËSHILLË LIGJORE: Të gjitha palët mund të paraqesin ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën e Apelit, nëpërmjet Gjykatës Themelore të Prishtinës brenda shtatë (7) ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes saj në pajtim me Nenin 310, paragrafi 1 i LPK-së në lidhje me Nenin 3 të LPJ-së.

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

CN.nr.249/2013 & CN.nr.467/2013 me datë 19 Gusht 2013



GJYQTARE E EULEX-IT ROSITZA BUZOVA

Pëpiluar në gjuhën Angleze si gjuhë zyrtare, sipas Nenit 17 të Ligjit nr 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.